



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 74-të të mbajtur më 05.09.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar m nr. 12-670/1 të datës 01.01.2021, me pretendimet për pakënaqësi ndaj procedimeve para prokurorisë publike kompetente dhe gjykatës kompetente, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse vlerësoi se kompetent për të vepruar janë organet tjera.

Lënda me numër 12-670/1 të datës 01.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsytim

Më 01 janar 2021, u dorëzoi denoncim me pretendime për pakënaqësi ndaj procedimeve para prokurorisë publike dhe gjykatës kompetente dhe u formua lënda me numër 12-670/1 e 01.01.2021.

Në denoncim, parashtruesi deklaroi se në vitin 2017 ka ngritur padi penale kundër një avokati të dyshuar nga ----- për krime mashtrimi, falsifikim dokumentesh dhe raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve. Prokuroria themelore publike -----, duke vepruar pas denoncimit, në 2020 vendosi të hedhë poshtë ankesën penale. Parashtruesi paraqiti ankesë deri te Prokuroria e lartë publike----- e cila e konfirmuar vendimin e shkallës së parë. Në të njëjtën kohë, parashtruesi pohoi se më parë kishte ndjekur procedurë gjyqësore , në të cilën në shkallën e parë personi i denoncuar ishte i akuzuar për faj, por u lirua në një procedim të mëvonshëm apeli. Ai dyshon për sjellje të prirjes dhe të paligjshme në procedimet përpara prokurorisë publike dhe gjykatës kompetente.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në lëndë dhe propozimeve të dorëzuara [01], KSHPK-ja konstatoi se në denoncim bëhet fjalë për lëndët që janë subjekt i autoriteteve të pranimit të Këshillit të Gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është kompetentë [02][03] [04][05] që ta ndjek dhe vlerëson punën e gjykatës dhe të vepron sipas parashtresave dhe kërkesave të qytetarëve dhe personave juridik për punën e gjykatësve, kryetarëve të gjykatës dhe gjykatësve, si dhe [06]Këshillin e prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili vepron sipas parashtresave dhe ankesave të qytetarëve dhe personave juridikë për punën e prokurorëve publikë.

Nga këtu, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin konkret, ndërsa denoncimin ta dorëzoj për veprim kompetent në Këshillin gjyqësorë të RMV-së, pas së cilës vlerësoi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Dorëzuar deri te:

Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska